

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

Përrulja / et-Tewaadua' / التَّوَّاضِعُ

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ thotë:

"وَعِبَادُ الرَّحْمَنِ الَّذِينَ يَمْشُونَ عَلَى الْأَرْضِ هَوْنًا"

"Robërit e Mëshirëplotit janë ata, që ecin tokës të përrulur." (el-Furkaan, 63)

Përrulja për robin do të thotë nënshtrim ndaj madhësisë të së vërtetës.¹ Kjo ka tri nivele:

Niveli i parë është përrulja para fesë. Kjo do të thotë që personi:

- Të mos kundërshtojë provat e transmetuara nga njeriu i arsyeshëm
- Të mos vërë në dyshim provat e fesë²
- Të mos kërkojë justifikime për divergjencë (mosmarrëveshje, dallime)

Kjo s'do të arrihet, përveçse pasi të marrësh vesh se shpëtimi varet nga të kuptuarit e thellë, besueshmëria varet nga mirëbesimi, dhe qartësia arrihet nëpërmjet provave të duhura.

Niveli i dytë nënkupton që:

- T'i pranosh si vëllezër ata që Allahu i ka pranuar si robër të nënshtruar (muslimanë) të Tij³

¹ Pejgamberi ﷺ tha: "Vërtet Allahu është i bukur dhe pëlqen të bukurën. Mendjemadhësi është ta refuzosh të vërtetën dhe t'i përbuzësh njerëzit." (Muslim)

² Më parë duhet të vësh në dyshim intelektin dhe të kuptuarit e tënd. Provat e fesë, të vendosura përfundimisht, asnjëherë s'do të jenë në kundërshti me realitetin, por të kuptuarit e personit për realitetin mund të jetë i gabuar. Logjika dhe filozofia e pakët mund të të çojnë në mosbesim; logjika dhe filozofia më e thellë do të të kthejnë në besim.

- Kurrë të mos ua mohosh të drejtat armiqve tu⁴
- Të pranosh justifikimet nga ata që përpiqen të justifikohen

Niveli i tretë është që të shfaqësh përlulje ndaj të Vërtetit, duke hequr dorë:

- Nga opinionet dhe shprehjet e tua ndërsa i shërben Atij⁵
- Nga mendimi se ti meriton shoqërimin me Të⁶
- Nga të parët e imazhit tënd ndërsa sheh Atë⁷

³ Dhe, nëse ata janë vëllezërit e tu, s' duhet ta konsiderosh veten më superior se ata. Në fakt, Bejezid el-Bistami tha se përlulje do të thotë të mos konsiderosh asnjë krijesë më të keqe apo më të ulët sesa vetveten.

⁴ Ky është testi i vërtetë i përluljes. T'ua pranosh të drejtat vetëm miqve s'është përlulje. Allahu tha: "Mos lini që armiqësia ndaj një populli t'ju pengojë të jeni të drejtë." (el-Ma'ideh, 8)

⁵ Domethënë, pajtim të plotë me hyjnoren. Dhe shpërbërja e vullnetit tënd në të Tijin është synimi.

⁶ Të shfaqësh mirënjohje, kur Ai të fton t'i afrosh dhe të lë të kënaqesh në rehatinë e intimitetit (*uns*) me Të, por kurrë të mos e marrësh këtë si një të drejtë tënden.

⁷ Sepse të parët e vetvetes (egos) pengon nga të parët e vetëm të Vërtetit. Drita e paraqitjes së Tij, për ata që bekohen me të parët e Atij me sytë e zemrës, do ta thërrmojë errësirën e egove të vdekshme.